

R E L A C I O N

mbi

VENDIMIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Sarande, Dhjetor 2022

Te nderuar Keshilltare!

Projekt Buxheti i vitit 2023 synon konsolidimin e ekonomise vendore, pasi me rimekembjen pas dy viteve te veshtira recesioni ekonomik rajonal dhe me gjere, po perballlet perseri me efektet e krizes ekonomike globale, qe ka dhene ndikimet e saj edhe ne ekonomine tone kombetare, e pasuar me rritjen e inflacionit ne menyre te ndjeshme. Per te mbeshtetur pushtetin vendor, per kapercimin e veshtiresive ekonomike si efekt i rritjes se ndjeshme te cmimeve, Qeveria ka miratuar ne buxhetin 2023 paketave financiare ne funksion te kompesimit te rritjes se kostove te sherbimeve publike, me fonde shtese ne formen e transfertave, duke e bere pothuajse te pacenueshem funksionimin e Pushtetit Vendor.

Per hartimin e Projekt Buxhetit Vjetor dhe Afatmesëm 2023-2025 jemi bazuar ne politika reale dhe te kujdeshme në kuadrin makroekonomik. Njekoheisht, per hartimin e Buxhetit Vendor administrata eshte bazuar ne politika te studjuara fiskale vendore, qe do te ndermerren edhe gjate zbatimit te Buxhetit per vitin 2023, me synim rritjen graduale te te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore , nepermjet stimulimit te sipermarrjes private.

Pas recesionit të fortë në vitet 2020-2021, parashikohet rikuperimi dhe rritja e te ardhurave vendore e perlloritur me **11%** te buxhetit te pritshem. Ekonomia vendore pritet kete permiresim te ndjeshëm në vitin 2023, duke vijuar këtë trend pozitiv dhe në periudhën afatmesme 2023-2025 me një mesatare prej **5-6 përqind**. Rritja ekonomike, do të pasohet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej **35% e totalit te Buxhetit**.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi **i të Ardhurave Buxhetore** mbështet synimet e Bashkise për qendrushmeri dhe rritje ekonomike, mbajtjen nën kontroll të shpenzimeve buxhetore dhe relizimin ne rritje te investimeve publike. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal, eliminimin e informalitetit ne ekonomi, stimulimin e sipermarrjes private duke siguruar në këtë mënyrë rritjen e vazhdueshme te nivelit ekonomik vendor.

Rritja e te ardhurave favorizon **Shpenzimeve Publike** vendore ne mbeshtetje te objektivave te Pushtetit Vendor per periudhen afat mesme 2023-2025 , nderkohe qe ne kushtet e rritjes se inflacionit, do te duhet qe ky buxhet te perballoje edhe rritjen e kostove shtese ne sherbimet e domosdoshme publike e perlloritur deri ne 20% te buxhetit aktual.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2023-2025 do të mbështesin një nivel të konsiderueshem **Investimet Publike** duke u përqendruar në financimin e projekteve në zbatim, projekteve të reja të rëndësishme në sektorin e kulturës dhe turizmit, si edhe infrastrukture. Investimet e parashikuara synojnë finalizimin e projekteve në proces për Ujësjelleshin, dhe fillimin e projekteve të reja në Infrastrukture, Arsim, Kulture dhe Bujqësi.

Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2023

Duke u mbështetur mbi treguesit pozitivë të ecurisë së decentralizimit fiskal dhe rritjes së cilësisë së Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor, Bashkia do të ketë prioritet përmirësimin e administrimit të funksioneve, dhe rritjen cilësish të menaxhimit financiar vendor në funksion të rritjes cilësish të shërbimeve publike. Rruajtja e trendit pozitiv të ecurisë së konsolidimit financiar të Bashkisë Sarandë dhe zbatimi i plotë i të gjitha metodologjive të hartuara nga MFE janë tregues të rëndësishëm për vazhdimin e reformimit të menaxhimit financiar vendor. Në këtë këndvështrim, disa nga objektivat për vitin 2023 për Buxhetin Vendor janë:

- Rritja e burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 126.8 milion lekë ose 18 % në raport me Buxhetin 2022, rritje e cila sigurohet të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në shpenzimet për investime;
- Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime në 35% të buxhetit, dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
- Rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor përmes rritjes së cilësisë, administrimit dhe qeverisjes më të mirë të financave publike;
- Rritja së transparencës dhe llogaridhënies së Qeverisjes Vendore në raport me komunitetin;
- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në Menaxhimin e Vështirësive Financiare.

Objektivat e vendosura nga Pushteti Vendor kanë për qëllim përmirësimin jo vetëm të jetesës së banorëve rezidentë në Bashkinë e Sarandës, por pritjen e miliona vizitorëve gjatë gjithë vitit në mënyrë dinjitoze me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase e cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore të larmishme e me hapësira të

dedikuara për fëmijët, të moshuarit, këmbësorët. Do të punojme pa ndalur , për ta kthyer potencialin e Sarandes në mireqenie për qytetaret e saj, dhe një shtëpi të madhe për të gjithë qytetaret që investojnë për të jetuar dhe punuar në perlen e Bregdetit Shqiptar.

Faleminderit për mbështetjen Tuaj !

KRYETAR

Adrian GURMA

TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2023

I. Parashikimi i te Ardhurave

Parashikimi buxhetor i te ardhurave vendore, bazohet ne realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifate , nga transfertat e pakushtezuar dhe transfertat specifiket. Ne reference te pritshmerise te realizimit 2022, ku te ardhurat priten te kene nje rritje te qendrueshme kryesisht ne kategorine e taksave, edhe parashikimi per vitin 2023 eshte bere ne kete progression. Rimekembja e ekonomise vendore ka bere qe politikat dhe objektivat e Bashkise te parashikojne rritjen e buxhetit me 11.2 % ne raport me buxhetin e vitit aktual.

Megjithese te ardhurat ne total kane qene ne nje të qëndrueshme pas Reformës Administrativo-Teritoriale, te para ne menyre analitike nga pikëpamja e burimit, rritja e te ardhurave parashikohet te jete me propocionale. Ashtu, si tregohet dhe në grafiket më poshtë, në përbërjen e të ardhurave në buxhetin e bashkise pamvarësisht rritjes se konsiderueshme të të ardhurave të veta akoma një peshë të konsiderueshme e mbajnë transfertat e buxhetit qendror. Përkatesisht këto transfertat nga buxheti qendror janë në masën 39 % (përfshirë transfertin e pakushtezuar sektoriale) krahasuar me 61 % që kanë të ardhurat e veta. Në këtë drejtim, gjithnjë dhe më shumë në kuadër të proceseve të decentralizimit politikat e pushtetit vendor vënë theksin në rëndësinë që ka rritja e të ardhurave nga burimet e veta vendore, në mënyrë që te ardhurat e veta te jene dominuese ne strukturen Buxhetore.

Pavarësisht ngadalësimit të rritjes ekonomike në keto dy vite, sektorët kryesorë të ekonomisë vendore si dhe treguesit makroekonomike, deri më tani kane mbajtur qendrueshmeri ne treguesit e te ardhurave. Referuar ketyre treguesve optimiste kemi parashikuar qe perspektiva e te ardhurave për vitin e ardhshëm dhe afatin e mesëm te jene ne rritje. Per vitin 2023 rritja e te ardhurave vendore (taksave dhe tarifave) parashikohet te jete 11.2%.

Programimi i të ardhurave për vitin 2023, eshte referuar te ecurise se realizimit te te ardhurave ne terma afatmesem, potencialin ekonomik te dhe rritjen ndjeshme te siper marrjes private, ku mbështen synimet e objektivave te pushtetit vendor. Rritja e parashikimit te burimeve vendore mbeshtetet edhe në përmirësimin e administrimit fiskal nëpërmjet taksimit te ndershem, zerimin e evazionit fiskal, si edhe informalitetit në ekonomi, duke mbështetur rritjen e te ardhurave vendore ne menyre të sigurt dhe te qëndrueshme.

Për vitin 2023 ne paketen fiskale te Bashkise Sarande nuk jane parashikuar ndryshime. Prioritet do jetë zbatimi dhe matja e efekteve të politikave fiskale të miratuara ne 2-3 vitet e fundit, me qëllim konsolidimin e sistemit tatimor. Ne vemendje te vecante do te jete formalizimi i bizneseve pjese e sistemit te taksave dhe tarifave vendore, si nje burim i qenesisesh per rritjen e te ardhurave buxhetore.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave;

Te Ardhurat Totale Buxhetore 2023 jane parashikuar ne Vleren 1,620,448 mije lek me rritje ne 25% krahasimisht me buxhetin 2022.

Te ardhurat nga burimet vendore per vitin 2023 planifikohet te jene ne shumen 503,500 mije lek, me nje rritje prej 11% krahsuar me te ardhurat e pritshme 2022 .Te ardhurat vendore perbehen nga te ardhurat tatimore (nga taksat) dhe te ardhurat jotatimore (nga tarifat per sherbimet publike) .

Te ardhura nga burime qendrore, te pakushtezuara dhe te kushtezuara perbejne 52% te buxhetit total te bashkise ne vleren 758,741 mije lek ku perfshihen *transferta e pakushtezuar, transferta e pakushtezuar sektoriale* per funksionet e deleguara , *transferta e kushtezuar* e destinuar si ndihme per shtresat ne nevojë si edhe *financimet nga FSHZH* per investime ne infrastrukturen publike vendore. Per vitin 2023 buxheti i transfertes nga buxheti i shtetit eshte ne masen 23%, ku rritje te ndjeshme ka pesuar transferta e pakushtezuar me 19% dhe transferta e pakushtezuar sektoriale me 4%. Risi ne kategorine e transfertave te pakushtezuara eshte shtesa ne buxhet e fondit per pastrimin e mbetjeve urbane ne vleren 42,600 mije lek.

- **Burimet financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave te pushtetit vendor.**

Struktura dhe ecuria ne realizimin e burimeve vendore në periudhën afatmesme 2023-2025 evidenton qendrushmerine dhe **trendin pozitiv** ne terma te pergjithshem, pavaresisht treguesve negative makroekonomike te dy viteve te fundit. Persa u perket zerave te vecante ne perberje te taksave dhe tarifave (kryesisht te perkohshme) evidentohen luhatje dhe paqendrushmeri ne realizimin e parashikimit në periudha e zëra të veçantë. Trajtimi ne periudha afatmesme te ecurise se realizimit ze per ze dhe ne total te te ardhurave ekspozon qasjen pozitive të rritjes së peshës specifike të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore. Raporti per periudhen 2019-2023 i te ardhurave vendore eshte rritur me rreth 23% dhe persa i perket raportit te transfertave te pakushtezuara per te njejten periudhe rritja eshte me rreth 40% , rritje kjo qe perkon edhe me rritjen e inflacionit vitin e fundit dhe nevojën per mbulimin e koston shtese te sherbimeve publike.

Ne perberjen e buxhetit te ardhurave totale te Bashkise Sarande, kontribuojne ;

- ✓ Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore jane pzrashikuar me peshe prej 34% te totalit te te ardhurave buxhetore.
- ✓ Te ardhura nga transfertat e pakushtezuara zene rreth 23 % te totalit te buxhetit.
- ✓ Te ardhurat transfertat e kushtezuara (FSHZH dhe ndihmat sociale) ne 29 % ne totalin e buxhetit.
- ✓ Te ardhurat e paperdorura nga viti aktual jane parashikuar te zene rreth 14% te totalit te buxhetit.

Taksat dhe Tarifat vendore te analizuara ne periudhe afat mesme, evidentohen realizime me luhatje ne ulje dhe ngritje duke bere te pasigurt dhe te paqendruesheme strukturen e buxhetit vendor. Megjithate eshte bere e mundur nje parashikim racional me paqendrueshmeri te moderuara nga viti ne vit, por ne terma te pergjithshem Buxheti i te ardhurave vendore ka trend rrites.

Transferta e pakushtezuar eshte parashikuar ne rritje me **19%** ne raport me nje vit me pare. Rritja e fondit te pakushtezuar do te shkoje ne mbulimin rritjes se kosos te shpenzimeve per investimet dhe sherbimet publike, si edhe shtesa e pagave te ndryshuara me VKM e shtator 2022, si pakete e ndermarre nga qeveria per zbutjen e krizes rajonale dhe rritjen e inflacionit.

Transferta e pakushtezuar sektoriale eshte parashikuar ne rritje me rreth **4.1%** krahasimisht me alokimin e fondit per vitin 2022, te cilat do te shkojne ne mbeshtetje te sektoreve te arsimit, bujqesise dhe te mbrojtjes nga zjarret.

Transferta e pakushtezuar per ndihma ekonomike dhe paaftesi eshte planifikuar ne ulje me rreth **3.6%** nga nje vit me pare. Ne fondin per investime jane parashikuar projektet qe aktualisht jane ne zbatim me financim nga buxheti i shtetit dhe projekte te reja ne zbatim.

Te ardhurat nga FSHZH jane projektet, ne ujesjelles dhe bujqesi te miratuara per financim nje vit me pare, dhe realizimi i tyre shtrihet ne periudhen 3 vjecare 2023-2025. Per vitin 2023 projekti i ri i miratuar per financim nga FSHZH eshte "Rikonstruksion i Shkolles 9 vjecare Adem Sheme", dhe rikonstruksioni i Kinoteatrit te Qytetit per ti dhene jete nje nga veprave me vlere kulturore, te Sarandes.

Te ardhurat e paperdorura jane nje ze i rendesishem ne buxhet qe perfaqesojne rreth 14% te totalit te buxhetit. Mbarjta nga njeri vit ne tjetrin ka te beje jo vetem me zbatimin e buxhetit, por edhe e realizimit te te ardhurave ne menyre te paparashikuar ne zera te vecante si ajo e taksas se ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja.

1.1 Te ardhurat nga burimet e veta vendore.

Planifikimi behet ne zbatim te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", mbeshtetur ne paketen fiskale per vitin 2023, ne perberje te se ciles jane, lloji i taksave, tarifave, baza e taksueshme, kategorite e bizneseve dhe kestet e pagesave pergjate gjithë vitit, si dhe menyren e vjeljes se tyre

Të ardhurat nga burimet e veta vendore per vitin 2023 jane perlogaritur ne vleren **503,500 mije** lek, duke shenuar rritje ne totalin e buxhetit krahasimisht me nje vit me pare me rreth **11%**. Per Bashkine te ardhurat e veta jane thelbesore per te qeverisur suksesshem, edhe per faktin se ne strukturen e buxhetit zene nje pjese te konsiderueshme te burimeve financiare.

Me tendence ne rritje progresive dhe perberje rreth **72%** te struktures se buxhetit nga te ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuara, kjo kategori te ardhurash perben pjesen me te rendesishme te totalit te burimeve financiare vendore. Në fund të vitit 2022, realizimi i planit ne buxhetit nga të ardhurat e burimeve te brendshme vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me aset

dhe të tjera) pritet të tejkalojë parashikimin buxhetor vjetor si pasoje e tejkalimit të të ardhurave në zera të taksave të paparashikueshme.

Të ardhurat vendore janë parashikuar në të dhenat baze dhe në nivelin aktual të cdo takse dhe tarife miratuar me ligjet në fuqi. Gjithashtu parashikimi buxhetor i të ardhurave është bazuar edhe në analizën e trendit të të ardhurave të taksave dhe tarifave, për një periudhë afat mesme. Ky parashikim është korrigjuar me efektet e **faktorëve të tjerë të jashtëm** për secilin ze të ardhurash. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë për bazë modelin të projeksionit të të ardhurave të pritshme për periudhën aktuale.

Faktorët e jashtëm që ndikojnë në parashikimin e të ardhurave për vitin 2023 janë:

- **Situata Makroekonomike.** Duke qenë se buxheti qendror luan një rol të rëndësishëm në buxhetin lokal, nepermjet alokimit të fondeve për veprimtari të caktuar të ekonomisë vendore, një tkurrje e ekonomisë kombëtare sikundër ka ndodhur në 2 vitet e fundit jep efektet e saj edhe në Buxhetin Vendor.
- **Politikat fiskale.** Për vitin 2023 në paketën fiskale **nuk** do të ketë ndryshime në nivelin e të taksave dhe tarifave të shërbimit në abonentët familjare edhe sektorin privat. Kjo gjë e përjashton mundësinë e parashikimit të buxhetit në rritje nga ky faktor.

Tabela 1. Të ardhurat nga burimet vendore dhe transfertat e pakushtezuara

nr	Te ardhurat vendore	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Ndryshimi 2023-2022	Pesha specifike
1	Nga burimet e veta vendore	426,500	432,000	450,000	503,500	53,500	43%
a	Te ardhura tatimore-taksat	272,500	284,500	301,000	349,100	48,100	
b	Te ardhura joutimore - tarifat	154,000	147,500	149,000	154,400	5,400	
2	Te ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm	222,105	190,000	230,000	241,876	11,876	21%
3	Te ardhura të trashëguara me destinacion				116,331		
4	Te ardhura nga burime qendrore	231,120	249,019	244,433	317,741	73,308	27%
a	Transferta e pakushtezuar	129,131	145,312	134,873	161,021	26,148	
b	Transferta e pakushtezuar sektoriale	101,989	103,707	109,560	156,720	47,160	
	Totali	879,725	871,019	924,433	1,179,448	255,015	90%

E përveç sipas kontributeve, performanca pozitive e të ardhurave nga burimet e veta është përcaktuar kryesisht nga kontributi i të ardhurave nga taksat vendore me rreth 69% të të ardhurave vendore. Rritja e të ardhurave nga taksat është parashikuar në vlerë 33,100 mijë leke duke shënuar rritje të konsiderueshme me 13 % krahasuar me një vitin që po lëme pas.


Parashikimi ne rritje i buxhetit nga taksat eshte perlogaritur ne reference te realizimit faktik te periudhes aktuale, ne faktore te tjere te jashtem. Nderkohe ka taksa me realizim mbi parashikimin buxhetor per periudhen aktuale, por qe per periudhen e ardhshme mund te mos jene ne te njejtat nivele pasi faktoret qe percaktojne realizimin e te ardhurave nga keto burime jane te paqendrueshem dhe te paparashikueshem. Keto taksa kane natyre ciklike dhe e vendosin buxhetin ne shtate jo te qendrueshme dhe krijojne boshlleqe ne periudha te paparashikuara, dhe ne parashikimin e te ardhurave nga taksat jane shmangur ndikimet e medha nga keto rritje fictive.

Ritje te ardhurash eshte perlogaritur edhe ne kategorine e tarifave me 6.03%. Të ardhurat nga *tarifat* jane po aq te rendesishme ne buxhetin vendor sa edhe taksat. Niveli i Tarifave eshte i lidhur drejtë persdrejti me kostot e sherbimeve publike qe ofron Bashkia ne te gjitha territorin e saj. Ne paketen fiskale te vitit 2023 nuk do te kete ndryshin ne nivelin e tarifave te te gjitha kategorive. Pesha qe zene te ardhurat nga tarifat ne strukturen e burimeve vendore eshte 27.6% te totalit te buxhetit .

Te ardhura te *paperdorura* jane gjithashtu nje ze l rendesishem te ardhurash ne strukturen e buxhetit pasi ne buxhetin e Bashkise kane qene nje shume e konsiderueshme. Shuma e parashikuar ne ulje e te ardhurave te paperdorura tregon zbatimin korrekt te buxhetit vjetor. Detyrimet e prapambetura te martura prej vitesh do te parashikohen per tu likuiduar per vitin e ardhshem dhe nje faktor pozitiv ne realizimin e ketij objektivi jane edhe te ardhurat e paperdorura te cilat na e bejne te mundur kete parashikim buxhetor.

Grafiku 1. Kontributi sipas kategorive te te ardhurave ne Buxhet.

ne 000/leke



I.1.1 Taksat vendore

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë burimin më të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore me 67% të totalit të burimeve vendore. Taksimi për bizneset për taksat vendore bëhet në zbatim të Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave vendore”. Parashikimi i të ardhurave nga taksat për vitin e ardhshëm është **342,100 mijë lek** me një rritje prej 13% , dhe **41,600 mijë lek** krahasuar me vitin aktual.

Baza e taksueshme është faktori kryesor nëpërmjet të cilit bëhet parashikimi afat mesëm. Për vitin 2021 rreth 100 biznese janë shtuar numrit të aktiviteteve në të gjithë Bashkinë dhe 600 të tjerë janë riaktivizuar për periudhën e sezonit turistik, krahasimisht me vitin 2021. Rritja e bazës së taksueshme është edhe një siguri që çojnë të ardhurat nga taksat me rritje në mënyrë të qëndrueshme nga viti në vit.

Numri i familjeve që kontribuojnë në buxhetin nëpërmjet taksës së ndërtës është rreth 17,611 familje .

✓ **Taksa mbi pasuritë e paluajtshme**, është ndër burimet më të rëndësishme dhe premtuese për buxhetin vendor. Në terma strukturorë, të ardhurat nga *taksa mbi ndërtësat* zënë peshën më të madhe në totalin nga të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (92.5%). Angazhimi maksimal për përmirësimin e performancës së taksës mbi pasurinë e paluajtshme, mbetet një nga sfidat më të mëdha në proces jo vetëm të pushtetit vendor por edhe qendror në periudhën afatshkurtër e afatmesme. Plotësimi i regjistrimit qendror të pasurive të paluajtshme / kadastrës fiskale pritet të zvogëlojë kostot e administrimit të kësaj takse, të ndihmojë në standartizimin e praktikave lokale, dhe mbi të gjitha do të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e parashikimit të të ardhurave, si një nga elementet kyç të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

Për vitin 2023 vlerësimi për këtë kategori taksash është rritur me 7.5% në shumën **105,000 mijë lek**. Në strukturën e të ardhurave kjo takse zë peshën prej 39.8% të taksave dhe 23.6% të totalit të të ardhurave vendore. Faktorët që ndikojnë rritjen e të ardhurave nga kjo takse vlerësohen të jenë në rritje si pasojë edhe buxheti parashikohet të ketë rritje progressive edhe në periudhë afatmesme. Faktorët që ndikojnë në të ardhurat e taksës janë:

- Rritja e sipërfaqes të ndërtimeve të reja .
- Formalizimi i pasurive të paluajtshme ekzistuese.

a) Të ardhurat nga taksa mbi ndërtësat

Taksa mbi ndërtësat (banimi dhe biznese) zë peshën dominuese të totalit me rreth 93 % në taksat mbi pasurinë e paluajtshme. Për vetë natyrën premtuese që ka kjo kategori , i kushtohet një vëmendje e veçantë me përditësimet e kuadrit ligjor në mënyrë të vazhdueshme me synimin e pozicionimit të taksës së ndërtës sipas rëndësisë që ka prona. Saktësimi i bazës së dhanave nga administrata është objektivi kryesor mbi të cilin mbështet administrata për të bërë parashikimet buxhetore nga viti në vit në rritje. Parashikimi i të ardhurave prej **103,100 mijë**

lek, me rreth 3.9% rritje per vitin 2023 ne reference te rritjes se siperfaqes se ndertesave ne kete nivel.

Siperfaqja e ndertesave te banimit qe do te taksohet perlllogaritet rreth 1,537,896 m². Taksa e ndertesave per biznese ka per baze ndertesat ne meter katror qe perdoren per biznese. Per vitin 2023 do te taksohen rreth 2,807 ndertesat biznesi me rreth 298,819 m², te dhena keto te marra nga verifikimet ne terren dhe vetedeklarimet. Realizimi i kadstres fiskale do t'ju japi fund pasaktive ne vetedeklarimet dhe dhe l jep fund informalitetit dhe evazionit fiskal.

b)Te ardhurat nga taksa mbi token bujqesore.

Te ardhurat nga taksa mbi token bujqesore zene nje vend te moderuar me vetem 6 % ne taksen e prones. Kjo takse administrohet nga Bashkia ka per baze siperfaqen e tokes bujqesore , ne hektar ne pronesi ose ne perdorim nga fermeret.

Per vitin 2021 planifikimin i te ardhurave me vlere **6,000 mije lek** eshte bere duke u bazuar ne kapacitetin aktual te siperfaqeve te tokave bujqesore ne pronesi te fermereve ne territorin e bashkise dhe njesise administrative. Kapaciteti aktual i siperfaqes se taksueshme te tokes bujqesore eshte rreth 1,603 ha. Fakti qe jo e gjithe siperfaqja eshte e shfrytëzuar dhe e zhvilluar e ben jo pak te veshtire mbledhjen e kesaj takse e cila ne 40% te vleres se saj duhet te kthehet ne investim ne infrastrukturen bujqesore.

c)Te ardhurat nga taksa e truallit:

Te ardhurat nga taksa e truallit eshte relativisht nje takse e re, e aplikueshme per trojet me destinacion ndertimin dhe zhvillimin urban, me pronar individin. Kjo takse u vendos per here te pare ne paketen fiskale 2016 dhe me nje perlllogaritje fillestare eshte planifikuar **3,000 mije lek**. Realizimi i te ardhurave nga kjo takse eshte ne nivele te uleta , dhe per kete arsye parashikimi per vitin e ardhshem eshte ulur krahasimisht me nje vit me pare duke e lene ne 50% te vleres se vitit actual.

- ✓ **Taksa e Ndikimit në Infrastruktūrë** përbën një ndër burimet më të rëndësishme per momentin të të ardhurave të veta vendore, me realizim te priteshem me 195,000 mije lek ose 41% të totalit të të ardhurave vendore. Miratimi i Planeve të Përgjithshme Vendore pas Reformës Administrative Territoriale, i ka dhënë një dimension tjetër fushes se zhvillimit te sektorit te ndertimit duke u rritur me shpejtesi kerkesat per ndertime te reja dhe rjedhimisht edhe te ardhurat nga kjo takse eshte rritur ne shifra te paparashikueshme. Nderkohe kjo takse e shtuar rrit mundesia per mbeshtejten e investimeve ne infrastrukturen dhe sherbimet te zonave ne zhvillim ne gjithe territorin e Bashkise.
Realizimi i paparashkueshem i taksës, ben te paqendrueshem nivelin e te ardhurave vendore por megjithate taksa per ndertimet e reja ka nje vlere domethenese ne gjite buxhetin e Bashkise, per vete natyren destinacionit te saj, sidomos per infrastrukturen e asaj zone ku zhvillohet prona. E rëndësishme sa taksat e tjera me gjithe paqendrueshmerin e realizimit ne kohe te ndryshme, parashikimi per vitin 2023 te jete ne rritje me rreth 19% ne raport me nje vit me pare ne vleren 90,000 mije lek..
- ✓ **Taksa per zenien e hapësirave publike**, ka per baze te dhenash siperfaqet e plazheve te kontraktuara nga Bashkia dhe Agjensia Kombetare e Bregdetit. Per vete natyren e funksionimit te dhenies me qera te plazheve, parashikimi dhe realizimi i buxhetit eshte i paparashikueshem. Per vitin e

ardhshem është parashikuar buxheti me rritje me 16.7% si efekt i rritjes së sipërfaqeve të kontraktuara për plazh në vijën bregdetare të miratuar nga AKB dhe Bashkia Sarandë po në këtë përqindje. Për vitin 2023 përlogaritja është bërë **72,000 mijë lek** duke u kthyer si një nga taksat më të rëndësishme në Buxhet.

- ✓ **Taksa për shërbimin hotelier**, është parashikuar në të njëjtin nivel me vitin 2022 në shumën **24,000 mijë lek**. Kategoria e hotelerisë është ndër më problematike përse i përket të dhënave bazë të përlogaritjes së nivelit të të ardhurave duke qenë se metoda e vetedeklarimeve është përgjithësisht abuzive. Në kushtet e rimekëmbjes ekonomike pritet shtimi i frekuentuesve në gjithë territorin dhe si rezultat edhe të ardhurat të parashikohen me premtuese. Në referencë të realizimit të periudhës aktuale ku situata ka ende përmirësime parashikimi është në të njëjtat nivele. Hoteleria në territorin e Bashkisë ka një kapacitet prej rreth 3,600 dhomash në shfrytëzim me rreth 7,850 shterter.
- ✓ **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël**, për shkak të politikave reformuese të Qeverisë në vite vazhdoi edhe për vitin është parashikuar, në **500 mijë lek**.

Te ardhurat nga taksat e ndara (grantet)

a) Te ardhurat nga Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Kjo taksë administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastres. Taksa me nivelet e vendosura në Ligjin Nr. 9632 paguhet për kryerjen e regjistrimit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga ASHK, të cilat në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arketuar.

Planifikimi për vitin 2023 është bërë me 43% rritje në vlerën **15,000 mijë lek** është bërë duke pasur parasysh ecurinë e realizimit për vitin aktual. Edhe kjo taksë karakterizohet nga paqëndrueshmëria në realizimin e saj për vetë natyrën që ka.

b) Te ardhurat nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar në ligjin nr. 997 dt.28.07.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës ku pas arketimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Transporteve Rrugore në rolin e agjentit tatimor, dhe pasi arketon detyrimin nga pronari i mjetit në vlerën e taksës për automjetin, në bazë të numrit të mjeteve kalon 18% të shumës në llogari të bashkisë Sarandë. Planifikimi i pandryshuar prej **21,000 mijë lek** bëhet me të dhënat e marra nga agjenti tatimor në bazë të të dhënave të regjistruara për nivelet e taksave dhe numrin e automjeteve.

c) Te ardhurat nga Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe nga menyra e vendosjes së tyre:


- Tabela për qëllime identifikimi, që janë brenda territorit ose në trup të biznesit.
- Tabela për qëllime reklamimi, që nuk janë brenda territorit ose në trup të biznesit.
- Tabela për qëllime ekspozimi, me karakter të perkohshëm.

Për vitin 2023 taksa e tabelës është parashikuar, në shumën 3,000 mijë lek.

Tabela.2 te ardhurat nga taksat


	Llojet e te ardhurave	V 2019	V 2020	V 2021	V 2022	V 2023
A	Te Ardhura nga taksat	265,350	272,500	284,500	301,000	342,100
A.1	Te ardhura nga taksat lokale	231,500	239,000	251,000	267,000	300,100
	Taksa vendore mbi Biznesin e vogel	7,500	13,000	1,000	500	500
1	Taksa vendore mbi pasurine e paluajtshme	99,000	99,000	99,000	106,500	110,600
	a- Taksa mbi ndertesën	90,000	90,000	90,000	99,000	103,100
	b- Taksa mbi token bujqesore	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000
	c- Taksa mbi truallin	3,000	3,000	3,000	1,500	1,500
2	Taksa vendore per sherbimin hotelier	23,000	24,000	24,000	24,000	24,000
3	Taksa per ndikim ne infrastrukture per ndertimet e reja	59,000	60,000	73,000	73,000	90,000
4	Taksa e tabelës	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000
5	Taksa per zenie hapësire publike	40,000	40,000	51,000	60,000	72,000
A.2	Te ardhura nga taksat e ndara	33,850	33,500	33,500	33,500	42,000
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pasurise	8,500	8,500	8,500	8,500	15,000
2	Taksa vjetore te mjeteve te perdorura	19,000	19,000	19,000	19,000	21,000
4	Taksa per zenie hapësire publike per reklama	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000

Grafik 2. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë ne 000/leke



- Kontributi i taksave ne Buxhetin Vendor paraqitet si me poshte:

Grafiku 3. Struktura e taksave ne %.



I.1.2 Tarifat vendore

Sipas ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen Vendore” Bashkite krijojne te ardhura nga tarifate vendore per sherbimet publike qe ato ofrojne; te drejten e perdorimit te pronave publike, dhenien e lishensave, lejeve, autorizimeve dhe leshimeve te dokumentave te tjera per te cilat kane autoritet te plote. Bashkite vendosin vete per nivelin, menyren e mbledhjes dhe te administrimit te tarifave vendore ne perputhje me politikaten dhe parimet e pergjithshme te percaktuara ne ligj.


Tabelë 3. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në 000/ lekë)

Kategorite e tarifave	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Pesha specifike
Tarifë pastrimi dhe menaxhim mbetjesh	68,000	73,000	80,920	85,740	62%
Tarifa për ndriçimin publik	15,000	15,000	15,000	16,060	12%
Tarifa për gjelbërimin	7,000	7,000	7,000	8,200	6%
Të ardhura nga tarifate e shërbimeve administrative	36,500	24,000	20,000	21,320	15%
Tarifa te tjera	11,000	10,500	8,500	8,080	6%
Totali	137,500	129,500	131,000	139,400	100%

Të ardhurat nga tarifate vendore përfaqësojnë një burim po aq te rëndësishëm të ardhurash sa edhe taksat në buxhetin vendor. Pesha ne totalin e te ardhurave eshte 23% me 3% me pak krahasimisht me nje vit me pare per arsyen se te ardhurat nga taksat kane pesuar rritje me te madhe se tarifate ne vlere absolute dhe perqindje.

Tarifate përfaqësojnë një kategori të ardhurash mbi të cilat bashkia kanë të drejta të plota vendimarrje. Në përgjithësi, të ardhurat nga tarifate vendore paraqesin prirje rritëse nga viti në vit.

Grafiku 4 . Ecuria e realizimit te tarifave vendore ne 000/leke



- ✓ **Tarifat nga shërbimet publike**, që përfshin kryesisht pastrimin dhe mbledhjen e mbetjeve urbane, për vitin 2022 megjithëse pa rritje krahasuar me vitin 2021, është në nivele të qëndrueshme ndër vite në të ardhurat e veta të bashkise. Përdorimi i Ndërmarrjes të Ujësjetës, si agjent fiskal për mbledhjen e tarifave të shërbimeve publike nga rezidentet ka rezultuar një praktikë të mirë në administrimin e tarifave. Por gjithashtu konstatohet në shumë raste që me gjithë synimin dhe orientimin ligjor, tarifat e mbledhura nga shërbimet publike nuk mbulojnë kostot përkatëse. Bazuar në problematikat e ndeshura vitin e fundit, NJVQV-të janë para obligimit dhe sfidave për të përshtatur metodologji specifike për llogaritjen e kostos së shërbimeve dhe shpërndarjen sa më të drejtë të barrës së detyrimeve midis bizneseve dhe qytetarëve duke ruajtur e zhvilluar një proces transparent me këto komunitete.

Parashikimi buxhetor për vitin 2022 nga tarifat e shërbimeve është në vlerën **139,400 mijë leke** në rritje prej 6% krahasimisht me një vit më parë. Rritje në zerin e të ardhurave nga tarifat është parashikuar në të ardhurat nga tarifa e shërbimit të pastrimit në subjektet private me natyrë kryesisht sezonale.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike, menaxhimi i mbetjeve, është parashikuar me **85,740 mijë lek** me një rritje prej rreth 5.6% në krahasim me një vit më parë. Rritja në parashikim është bërë në llogaritje të rritjes së tarifës së shërbimit për subjektet private me emetim mbetjesh në sasi të mëdha gjatë sezonit turistik. Po ashtu edhe baza e faturimit do të zgjerohet duke saktësuar sipërfaqen e ndërtesave të disponueshme nga bizneset, pasi faturimi do të bëhet/m².

Të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit janë planifikuar në rritje krahasimisht me një vit më parë me shumën 8,200 mijë leke në rritje me 14% ku faktori i rritjes është zgjerimi i bazës së faturimit.

Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit publik janë planifikuar në shumën prej rreth **16,060 mijë lekë**, në rritje me rreth 6% krahasimisht me një vit më parë, parashikim ky i bazuar si në pritshmerinë e realizimit të planit 2021, ashtu edhe në zgjerimin e bazës së të dhënave si familje ashtu edhe biznese kryesisht në sezonin e verës të cilët operojnë në 1/3 e vitit.

Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve publike per pastrimin e largimin e mbetjeve gjelberimin dhe ndricimin publik shlyhen ne baze mujore se bashku me faturen e sherbimit te furnizimit me uje tek Ndermarja e Ujesjelles Kanalizimeve sh.a Sarande , ne cilesine e agjentit tatimor.


Tarifat per sherbimet administrative jane parashikuar ne shumen **21,320 mije lek**. Sikunder cdo ze I buxhetit eshte parashikuar ne rritje edhe kjo kategori tarife eshte parashikuar ne rritje me reth 6%. Kjo rritje ven ne reference te realizimit faktik 2022 por edhe ne pritshmeri te shtimit te fluksit te frekuentimit te sherbimeve per vitin 2023.

Tarifa e parkimit per mjetet e lishensuara dhe vendparkimet publike eshte planifikuar ne te njejten shume me nje vit me pare **2,500 mije leke** e pandryshuar nga buxheti i vitit paraardhes. Me nje peshe prej 6.8% ne totalin e sherbimeve administrative, vlere per nje parkim te rezervuar vjetore eshte e pandryshuar edhe per kete vit duke u referuar ne kerkesat e pandryshuara per vende parkimi te rezervuara, dhe tarifa po ne te njejtat nivele edhe per 2023.

Tabela 4. Të ardhurat vendore ne Total sipas kategorive (në 000/ lekë)

Nr	Te ardhura nga burimet e veta vendore	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Pesha specifike
1	Te ardhura nga taksat	231,500	239,000	251,000	267,500	300,100	60%
2	Te ardhura nga taksat e ndara	33,850	33,500	33,500	33,500	42,000	8%
3	Te ardhura nga tarifat	126,000	137,500	129,500	131,000	139,400	28%
4	Te ardhura te tjera	14,500	16,500	18,000	18,000	22,000	4%
	Totali	405,850	426,500	432,000	450,000	503,500	100%

Grafiku 5 . Paraqitja grafike e struktures te te ardhurave vendore. (ne 000/leke)



Te ardhura te tjera.

✓ Te ardhura nga dhenia me qera e asetëve ne pronesi te Bashkise.

Ne buxhetin 2023 te ardhurat nga dhenia me qera e asetëve eshte parashikuar ne shumen **5,000 mije leke**, ne te njeitin nivel me nje vitin aktual. Parashikimi ne kete nivel behet duke u bazuar ne te dhenat baze mbi te cilat perlllogariten te ardhurat nga kjo kategori takse. Per nje periudhe te konsiderueshme nuk ka pasur kontrata te shtuara per dhenie me qera asetë te bashkise. Nje pengese per realizimin e ketij procesi eshte mungesa e rregjistrimit ne Kadaster ne pronesi te Bashkise te pronave qe ka nen administrim.

Peshen kryesore ne kete ze te ardhurash e zene qerate nga ndertesat ne pronesi te Bashkise me 41.8 % te totalit. Bazuar ne VKM nr 529/2014, date” Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe menyres se dhenies me qera, enfiteoze apo kontratat e tjera te pasurise shteterore” i ndryshuar. Pasurite qe jepen me qera jane ndertesat, trualli i lire. Perlllogaritja e ketij parashikimi behet mbi kontratat e lidhura ndermjet bashkise dhe qeramarresve.

✓ Te ardhurat nga shitja e trojeve.

Ne zbatim te VKM ne 329/2019 per shitjen e trojeve nga Bashkite eshte parashikuar ne buxhet shuma prej **8,000 mije lek** ne te njeitin nivel me vitin aktual. Ende konsiderohet si parashikim me rezerva, por ne varesi parashikimeve se procedures se rregjistrimit te trojeve, keto te ardhura pritet te jete ne ulje ne nje periudhe afatmesme.

✓ Te ardhura nga financim projektesh me BE

Per vitin 2023 do te parashikohet 6,000 mije lek per te siguruar financimin e projekteve qe jane aktualisht ne zbatim me financim nga fondet e BE.

1.2 Te ardhura nga Buxheti i Shtetit

Te ardhurat nga buxheti i shtetit alokohen ne formen e **transfertes se pakushtëzuar, transfertes sektoriale, transfertes se kushtëzuar dhe granteve per investime**. Transfertat nacionale perbejne një burim financiar thelbësor në përmbushje të funksioneve ekskluzive të bashkise, duke **synuar mbylljen e hendekut negativ midis nevojës për shpenzime dhe kapacitetit fiskal**. Perlllogaritja e transfertes se pakushtëzuar behetnga MFE specifikisht per cdo bashki duke marre per reference faktoret popullsi dhe kapacitetin fiskal.

Tabela 5. Te ardhurat nga burimet qendrore

ne 000/lek

Nr	Te ardhurat nga burimet qendrore	P.V 2019	P.V 2020	P.V 2021	P.V 2022	P.V 2023	Rritja ne %
1	Transferta e pakushtezuar	125,697	129,131	145,312	134,873	161,021	19.39
2	Transferta e pakushtezuar sektoriale	100,959	101,989	103,707	109,560	156,720	43.04
3	Transferta e kushtezuar	215,000	215,000	225,000	218,000	226,000	3.67
4	Grande qeveritare per investime	165,000	200,000	200,000	152,655	202,000	32.32
	Totali	646,120	646,120	674,019	615,088	745,741	21.24

Të ardhurat nga transferta e pakushtezuar per vitin 2023 nga Buxheti nacional eshte parashikuar ne shumen **161,021 mije lek**. Rritja ne 19% e fondit te pakushtezuar behet ne kuader te stimulimit qe qeveria ben per pushtetin vendor dhe individet per te perballuar rritjen e infcacionit ne menyre te ndjeshme si pasoje e krizes qe shkaktoi pasigurine ushimore , lufta ne rajon.

Te ardhurat nga transferta e kushtezuar sektoriale, jane te ardhura nga buxheti i shtetit per te financuar funksionet e deleguara te njesive te varesi te bashkise qe prej reformes territoriale ne vitin 2015 me strukturen **115 punonjes**. Kjo transferte financon shpenzimet per paga dhe sigurimet shoqerore per sektorin e arsimit, dhe nje pjese te shpenzimeve operative te sektoreve te tjere, pjese te kasaj transferte ne shumen **114,120 mije lek**, dhe vlera prej 42,600 leke per here te pare per buxhetimin e menaxhimi te mbetjeve.

Nderkohe qe kopetencat per menaxhim dhe detyrime shtese per financim i kane kaluar bashkise, duke bere qe nje pjese e kerkesave per fonde qe duhen per plotesimin e funksioneve te tyre, ti ngarkohen buxhetit vendor.

- ✓ **Konviktet e arsimit parauniversitar**, ne mbeshtetje te arsimit te mesem profesional , per vitin 2023 pjese e transfertes se pakushtezuar sektoriale eshte planifikuar per shpenzimet per pagat, sigurimet shoqerore, shpenzimet operative dhe investime ne vleren **19,124 mije leke** ne rritje me 2% ne raport me nje vit me pare. Standartet dhe kriteret e sherbimit do te kryhen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.
- ✓ **Sherbimi per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi (PMNZSH)**. Ne transferten e planifikuar per vitin 2023, jane fondet per PMNZSH. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sigurimeve shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **19,883 mije lek**. Nga buxheti i bashkise me te ardhurat e veta mbulohen edhe nevoja shtese te domosdoshme per kete sektor.
- ✓ **Personeli mesimor dhe personeli mbeshtetes ne arsimin parashkollor dhe personeli mbeshtetes ne arsimin parauniversitar**. Ne transferten sektoriale te vitit 2023, jane parashikuar fondet per personelin arsimor dhe ate ndihmes per arsimin parashkollor si dhe per personelin ndihmes per arsimin parauniversitar me perjashtim te arsimit te mesem profesional. Parashikimi i fondeve per kete vit jane ne shumen **65,563 mije leke** ne rritje me 5%per vitin 2023. Fondet e alokuara per kete program jane te destinuara per pagat dhe sigurimet shoqerore.
- ✓ **Administrimi i pyjeve**
Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2023, jane fondet per Sherbimin pyjor. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **2,806 mije lek**.
- ✓ **Ujitja dhe Kullimi**
Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2023, perfshihen edhe fondet per Ujitjen dhe Kullimin. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **6,744 mije lek**

Transferta e Kushtezuar

Transferta e kushtezuar perbehet prej;

- *Funksionit te deleguar per sherbimin e Gjendjes civile, 3,941 mije leke, fondet per mbeshtetje ekonomike per familjet ne nevoje dhe personat me aftesi te kufizuar 226,000 mije lek.*
- *Financimet e deleguara per investime jane parashikuar ne Shumen 202,000 mije lek.*

Bashkia perfiton fonde nga buxheti i shtetit nepermjet instrumentit te saj, Fondit Shqiptar te Zhvillimit per projekteve te aplikuara persa I perket infrastruktures dhe sherbimeve publike ne Bashkine e Sarandes. Ne pritje per financim te projekteve te miratuara, por edhe duke marre ne konsiderate miratimin per financim te projekteve ne zbatim prej vitit 2022 ne Shumen 177,461 mije lek , parashikimi per vitin 2023 eshte bere ne vleren e parashikuar. Projektet konsistojne ne permiresimin e infrastruktures ne sektorin e bujqesise dhe ate te ujesjellesit ne Njesine Administrative Ksamil, ne sektorin e Arsimit per rikonstruksionin e shkollave, dhe ne sektorin e Artit dhe kultures.

Grafiku 6. Struktura e te ardhurave me burime nga Buxheti i Shtetit





Tabela.6 Struktura e Totalit te te Ardhurave Vendore per vitin 2023.

Nr	Emertimi	V 2019	V 2020	V 2021	V 2022	Struktura	V 2023
1	Te ardhurat nga taksat dhe tarifat	405,850	426,500	432,000	450,000	31%	503,500
2	Transferta e pakushtezuar	125,697	129,131	145,312	134,873	10%	161,021
3	Transferta specifike	100,959	101,989	103,707	109,560	10%	156,720
4	Transferta nga FZHR per investime	215,000	215,000	200,000	152,655	12%	202,000
5	Transferta e kushtezuar per EC				13,000	1%	13,000
6	Transferta e kushtezuar per ndihma	165,000	200,000	225,000	218,000	14%	226,000
7	Te ardhura te paperdorura me desticion						116,331
8	Te ardhura te paperdorura	230,000	222,105	190,000	180,000	15%	241,876
	Shuma	1,242,506	1,294,725	1,296,019	1,258,088	100%	1,620,448

Ne strukturen e totalit te te ardhurave te Buxhetit te Bashkise Sarande per vitin 2023, peshen kryesore e zene **te ardhurat nga taksat dhe tarifat me 34% te totalit**. Te ardhurat nga **transfertat e pakushtezuara** gjithashtu jane po aq te rendesishme ne strukturen e buxhetit vendor me 22% te totalit. Transfertat e pakushtezuara me 30% te totalit perbehet nga transfertat e pakushtezuar dhe transfertat specifiket. **Te ardhurat me destinacion** gjithashtu jane pjese e rendesishme e buxhetit, edhe pse si funksione te deleguara, me **34% te totalit**. **Te ardhurat e paperdorura** kane nje rol te rendesishme per fillim vitin e ardhshem, dhe pse me shlyerjen e faturave te prapambetura te cilat jane ne minimumin e mundshem, trashegimi i te ardhurave nuk perfaqeson mungesen e likuidimit te faturave apo mosrealizimin e buxhetit , por ne perqindjen me te madhe te tij perfaqeson te ardhura suficit ne mbylljen e vitit 2022.

Grafiku 7. Struktura e Totalit te te Ardhurave Vendore



- Baza e taksueshme per kategorite e taksave dhe tarifave vendore

Baza e taksueshme per kategorine e taksave dhe tarifave vendore jane bizneset, familjaet dhe institucionet. Peshen me te madhe e mbajne familjaet te cilet perbejne rreth 83.2 % te taksapaguesve dhe me pas vjen biznesi i vogel me 16.8 % te totalit te te ardhurave. Me poshte paraqiten kategorite e taksapaguesve te ndara sipas lagjeve dhe njesive administrative.


Tabela 7. Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas numrit.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupeve (numri)						
Nr	Bashkia Sarande	Totali	Familjet	Biznes i vogel	Biznes i madh	Institucione
1	NjA Sarande	17,889	15,475	2,104	284	26
	Lagjia 1	4,080	3,305	651	112	12
	Lagjia 2	2,290	1,551	708	27	4
	Lagjia 3	2,350	2,082	231	31	6
	Lagjia 4	5,036	4,596	373	63	4

	Lagjia 5	4,133	3,941	141	51	
2	NjA te tjera		2,216	624	65	
	Nj,A Ksamil	2,905	2,216	624	65	
	TOTALI	20,794	17,691	2,728	349	26

Perqendrimi i bizneseve eshte kryesisht, ne zonat urbane ne Sarande dhe njesine administrative Ksamil. Veçoria e bizneseve qe operojne ne territorin e Bashkise eshte perqendrimi i larte i aktivitetit te biznesit ne periudha sezonale, dhe kjo dukuri veshtireson punen ne saktesine e te dhenave baze per evidentimin e bizneseve, duke u bere edhe nje faktor i mundshem informaliteti. Te dhenat tregojne se numri i bizneseve te vogla eshte ne rritje me rreth 10%, po ashu edhe familjaret dhe biznesi i madh jane ne rritje propocionale. Nje rritje e tille premtion per kontribut te ndjeshem ne buxhetin vendor si edhe rritjen e ekonomise vendore.

Grafiku 8. Struktura e se bazeve se taksueshme



II. SHPENZIMET BUXHETORE PER VITIN 2023

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën shtyllen tjetër të rëndësishme në Menaxhimin Financiar Publik Vendor. Ne buxhetin e vitit 2023, Bashkia Sarande kanalizon;

- 22% të totalit burimeve financiare për mbulimin e shpenzimeve per pagat dhe sig. shoqerore,
- 28% te buxhetit parashikohen per shpenzimet korrente,
- 18% te buxhetit, transfertat te brendshme
- 35% jane parashikuar për shpenzime kapitale.

Totali i parashikimit te buxhetimit te kerkesave buxhetore te Bashkise Sarande per funksionimin e pushtetit vendor, paraqet nje situatë të përgjithshme mbi mënyrën se si do te shpenzohen fondet në dispozicion:

- ✓ sipas burimit të financimit,

- ✓ sipas kategorizimit të natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe
- ✓ sipas funksioneve të programeve të qeverisjes lokale (arsim, shërbime publike, kulture, etj.).

Fondet në dispozicion të funksioneve të bashkise parashikohen në vlerën 1,620,448 mijë leke.

- Përfshirë të ardhurat e trashëguara, shpenzimet e planifikuara nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuara për vitin 2023 janë në vlerën **1,065,328 mijë lek**, me një rritje prej 23% në raport me buxhetin e vitit 2022.
- Shpenzimet e parashikuara me financim nga buxheti I shtetit për investime dhe ndihma sociale janë parashikuar **441,000 mijë leke** me rreth **15%** më shumë se një vit më parë.

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2022 nga të ardhurat vendore, transfertat e pakushtezuar dhe transfertat e pakushtezuar sektoriale është planifikuar të jetë **1,179,449 mijë leke** duke e mbajtur ritmin krahasimisht me një vit më parë në nivelin e **23,5%**.


✓ **Shpenzimet sipas burimit të financimit**

Në pasqyren e shpenzimeve paraqet një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën si janë shpenzuar fondet në dispozicion sipas programeve për vitin 2023: sipas burimit të financimit dhe kryqëzuar me kategorizimin sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike dhe kulturore, mbrojtje mjedisi, shërbime publike etj.).

- ✓ *Shpenzime nga të ardhurat e veta vendore (përfshirë të ardhurat e papërdorura)*, janë parashikuar **1,020,742 mijë leke** me përbërje të strukturës si më poshtë;
 - 18.3% shkojnë për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve,
 - 54.7% janë parashikuar për shpenzimet korrente,
 - 22% e shumës është parashikuar për shpenzime për investime publike në infrastrukturë dhe shërbime.
 - 5% e të ardhurave janë parashikuar për transfertat e brendshme.
- ✓ *Shpenzime nga transfertat e pakushtezuar (përfshirë edhe fondet e papërdorura)* janë parashikuar në shumën **396,794 mijë lek** nga të cilat;
 - 11.2% për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve,
 - 48.8% për shpenzimet korrente dhe
 - 40% për investime kapitale
- ✓ *Shpenzimet nga transfertat sektoriale* janë planifikuar në shumën **114,120 mijë lek**;
 - 17% shpenzime për konviktin e shkollës së mesme profesionale,
 - 56% shpenzime për arsimin e parauniversitar,
 - 17.6% për sektorin e zjarrfikësive,
 - 2.9% për administrimin e pyjeve,
 - 6.5% për sektorin e ujitjes dhe kullimit.

- ✓ *Shpenzimet nga Buxheti i Shtetit per investime* jane parashikuar ne shumen **202,000 mije lek** nga te cilat;
 - 43 % per rehabilitimin edhe permiresimin e rrjetit te ujesjellesit ne Njesine Administrative Ksamil dhe rrjetit te shperndarjes Sarande,
 - 57 % per Arsimin dhe Kulturen.
- ✓ *Shpenzimet nga transferta e kushtezuar per ndihma dhe paftesi* jane parashikuar ne shumen **226,000 mije lek**.
 - 93.5% parashikohen per transferen e aftesise se kufizuar,
 - 6.5% parashikohen per ndihmen ekonomike, per familjet ne nevoje.

Grafiku 8. Struktura e Shpenzimeve Buxhetore




✓ **Ndarja e fondeve buxhetore sipas natyres ekonomike;**

- *Shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore*, te cilat perbejne rreth **24%** te buxhetit total ne shumen **348,900 mije leke** me 7.8% rritje per vitin 2023. Ne kete vlere perfshihen pagat e **437 punonjesve** te aparatit te Bashkise , njesive te varesise, si edhe funksionet e deleguara .
- *Shpenzimet korrente* perbejne rreth **28 %** te totalit te buxhetit me nje shume prej **418,721 mije lek** ne rritje me 21 % ne raport me vitin korent. Ne kete ze buxhetor perfshihen te gjitha shpenzimet korrente per funksionimin e aparatit te Bashkise, sherbimet publike, shpenzimeve per mirembajtjen e njesive ne varesi dhe funksioneve te deleguara.
- *Shpenzime per transferta ne individe* (*ndihma ekonomike dhe paaftesi, etj*) perbejne **15 %** te buxhetit total ne shumen **285,512 mije lek**.
- *Shpenzimet per Investimet Kapitale* perbejne **35%** te totalit te buxhetit ne shumen **567,317 mije lek** nga te cilat ;

- Investime me financim nga te ardhurat e veta ne masen **44%** .
- Investime me financim nga buxheti i shtetit ne masen **36 %**.
- Investime te prapambetura 20%.

Grafiku 10. Shpenzimet sipas natyres ekonomike



✓ Shpenzimet sipas programeve buxhetore

Shuma ne dispozicion nga te gjitha burimet e te ardhurave do te jete per buxhetimin e te gjitha programeve , pjese perberese e funksionimit te pushtetit vendor. Bashkia e Sarandes ka ne perberjen e saj 12 programe te specifikuara me funksione te ndara, te harmonizuara ne menyre te tille qe te sigurojne realizimin e objektiveve te pushteti vendor. Perberja e programeve paraqitet si me poshte;

1. Menaxhim, Administrim, Planifikim (Aparati I Bashkise)

Buxheti per kete program perfshin shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore, shpenzimet korrente , shpenzimet per investimet publike si edhe transferta ne te trete apo ne individe ne shumen **674,388 mije lek duke zene 42%** te totalit te buxhetit;

- **Shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore**, llogaritjen e fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per administraten e Bashkise dhe punonjesit e njesise administrative, ne total **130 punonjes**. Ne Buxhetin 2023 per kete ze shpenzimesh jane parashikuar **127,682 mije lek**. Shtesa ne buxhet me 10% parashikohet per te perballuar rritjen e pagave per punonjesit civile dhe mbeshtetes miratuar me VKM nr.625/2022.
- **Shpenzimet korrentete te parashikuara ne shumen 141,236 mije lek** perfshijne;
 - Shpenzimet operative te parashikuara ne vleren 75,336 mije lek ne rritje me rreth 10% nga buxheti i vitit korent. Ne kete buxhet jane parashikuar te mbeshtet funksionimi i administrates, ne te gjithe sektoret e saj persa i perket bazes materiale, dhe sherbimet e tjera si uje energji dhe ato kontraktuale per funksionimin normal te pushtetit vendor.
 - Materiale zyre, kancelari, material pastrami, material per paisjet e zyrave, material promocionale, publikime , reklamime, promovime, uniforma per punonjesit e bashkise eshte parashikuar ne shumen **8,966 mije leke** me rritje ne zerin publikime dhe botime

ne vleren 1,200 mije lek, ku bashkia tashme ka botimin e revistes ne funksion te promovimit te Sarandes turistike kulturore dhe historike

- Sherbime nga te trete e parashikuar ne shumen 42,120 mije lek, pothuajse ne te njejtat nivele me nje vit me pare, perfshin shpenzimet per elektricitetin per Bashkine, per ndricimin publik, per administraten ne njesine administrative, per qendrat sociale etj. Ne kete ze shpenzimesh futet sherbimi i printimit per aparatit e bashkise, sherbimin telefonik, komunikim me mediat, si edhe mirembajtjen e sistemit elektronik ne te gjitha administaten perfshire edhe sistemin e kamerave te qytetit.
- Shpenzime per sherbime publike eshte parashikuar ne shumen 8,250 mije leke, ne te njejtat nivele me nje vit me pare, ku perfshihen; rehabilitime te infrastruktures ne plazhet publike, ndertsat ne administrim te Bashkise, trajtim te kafsheve te rrugeve, mjete per sigurimin e ruajtjes te jeteve ne det gjate sezonit turistik, mirembajtje dhe rinovim te paisjeve te PMNZSH- si edhe detyrime te paparashikuara administrative lidhur me natyren e sherbimeve qe ofron pushteti vendor.
- Shpenzime transporti jane parashikuar ne shumen 7,100 mije lek ne rritje me rreth 30% krahasimisht me vitin korent dhe kjo rritje perfaqeon rritjen e inflacionin , me ndikim te drejtperdrejte ne cmimin e karburantit. Ne kete ze shpenzimesh perfshihen shpenzimet per karburant mjetet e transportit ne funksion te administrates, shpenzimet per mirembajtjen e tyre, transporti interurban me mjete specifik me qera ne dite eventesh, si edhe per dokumentacionin ligjor te pervitshem. Ne kete shume te parashikuar ne buxhet perfshihen edhe shpenzimet per udhetim te punonjesve qe autorizohen te kryejne detyra jashte Bashkise.
- Shpenzime per mirembajtje te zakonshme jane parashikuar ne shumen 5,000 mije lek ne rritje me rreth 10% te njejtin nivel me nje vit me pare, per te perballuar rritjen e cmimeve te tregut per materialet e ndertimit, dhe ka parasysh te gjitha shpenzimet e nevojshme te kryhen ne ndertesat e amortizuara ne funksion te bashkise dhe njesive ne varesi te saj. Ne kete ze buxhetor eshte perfshire edhe mirembajtja e tokes bujqesore, pjese e takses se arketuar per vitin korent.
- Shpenzime per qeramarrje jane parashikuar ne shumen 1,500 mije lek dhe buxheton ndertesat dhe ambientet e marra me qera nga Bashkia per funksionet e veta.
- Shpenzime per pritje, percjellje dhe kuota pjesemarrje jane parashikuar ne shumen 900 mije leke ne te njejtat nivele me nje vit me pare dhe mbulon shpenzimet per pritje percjellje zyrtare si edhe kuota pjesemarrrese ne shoqata bashkish.
- **Shpenzime per keshilltaret** dhe kryepleqte e parashikuar, ne shumen **7,400 mije lek**. Ne kete shume perfshihen pagesat per pagat e keshilltareve dhe kryepleqve, te percaktuara ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi per vitin 2021, shpenzimet e udhetimit, si edhe shpenzimet per kancelari dhe material te nevojshme ne punen e tyre.
- **Shpenzime per promocion turizmi dhe projekte** eshte parashikuar ne shumen **20,500 mije lek** ne rritje me 7.5% krahasimisht buxhetin e vitit korent. Aktiviteti promocional i Sarandes perfshire edhe aktivitetet kulturore dhe argetuese gjate sezonit turistik eshte nje faktor shume i rendesishem dhe luan nje rol te konsiderueshem ne nivelin e


frekuentimit te Sarandes nga turistet. Per vete rendesine qe ka, i eshte kushtuar vemendje ketij sektori duke rritur nga viti ne vit mbeshtetjen buxhetore nga te ardhurat e bashkise. Fondet e parashikuara, do te mbeshtesin projektet sipas prioritetit, duke kaluar ne filtrin e specialisteve tef ushes se artit, cultures, krijimtarise dhe aktrimit anetare te Keshilli Artistik.

- Ne politikat afatmesme dhe afat gjata te Bashkise *Industria e Turizmit* parashikohet te jete shtylla kryesore e ekonomise vendore, per vete pozicionimin gjeografik te Sarandes dhe jo vetem per bregdetin e saj por edhe per vlerat kulturore dhe historike qe mbart komuniteti. Me shfrytezimin e resurseve Saranda dhe Ksamili gjithnje e me shume jane kthyer nje nder destinacionet me te frekuentuara ne vend. Synimi i politikave zhvillimore te pushtetit qendror dhe lokal eshte nxitja e nje zhvillimi te qendrueshem, te ekuilibruar ekonomik nepermjet politikave te bashkepunimit dhe nxitjes se siper marrjes private ne sktoirin e turizmit dhe jo vetem.
- Ne funksion te promocionit turistik strukturat e bashkise vendosin ne funksion te turistave qendra inormacioni me materialet e nevojshme informuese si guida, hartave turistike, publikimit ne faqen web te Bashkise Sarande te gjitha organizimeve dhe eventeve, organizion panairëve me pjesemarrjen e bizneseve qe operojne ne territorin e Sarandes, shfaqe dhe konkurse me talentet e reja, organizimi i nje sere eventesh kulturore dhe artistike pergjate vitit te pasqyruara ne buxhet. Bashkia do jete promotore e mbeshtetjes se zhvillimit te turizmit ne rajonin e bashkise Sarande me synimin e rritjes se nivelit ekonomik dhe standarteve te sherbimit ne nivele konkuresive me rajonin.
- Te mbeshtetur edhe nga politikat e Qeverise per arsimin profesional, nje vemendje e posatshme i kushtohet shkolles me drejtim Hoteleri -Turizem ne te cilen pregatiten per tregun e punes dhjetra profesioniste ne fushen e sherbimit dhe kulinarise, te domosdoshem per tregun e industries se turizmit ne Sarande dhe me gjere.
- **Shpenzime per agjentin tatimor** eshte parashikuar ne shumen **5,000 mije lek**. Ne ke fond eshte perlllogritur detyrimi detyrimi kontraktual qe lind nga perdorimi i agjenteve tatimor per mbledhjen e taksave dhe tarifave.
- **Shpenzime per bonus strehimi eshte parashikuar ne shumen 2,000 mije lek** ne rritje me 25% krahasimisht me buxhetin e vitit aktual. Fondi i parashikuar ne buxhet do te perdoret per kompesimin e qerases per shtresat ne nevoje doke zene rreth 50% te buxhetit total me kete destinacion, bashke me fonancimin e buxhetit qendror.
- **Fondi i emengjencave eshte parashikuar ne shumen 33,000 mije lek** dhe perben 4% te buxhetit me te ardhurat e bashkise dhe transferta e pakushtezuar dhe te trasheguarat nga viti 2021. Ky fond perbehet ne 60% nga te ardhurat e bashkise dhe 40% nga tranferta e kushtezuar. Parashikimi i vleres ne buxhet behet ne zbatim te Ligjit 45/2019 "Per mbrojtjen Civile".
- **Shpenzime per detyrimet e prapambetura 20,000 mije lek**. Parashikimi ne ulje ka te beje me uljen ne menyre te ndjeshme te perqindjes se detyrimeve te prapambetura per vitin 2022. Shuma e perlllogaritur perbehet nga detyrime ne te trete te

prapambetura ne Shumen 10,000 lek dhe pjesa tjetere ka te beje me kthime detyrimesh te arketuara ne menyre te pasakte nga Drejtoria e Planifikim Territorit.

- **Shpenzime per vendime gjyqesore jane parashikuar ne shumen 2,000 mije lek.** Perlllogaritja e ketij fondi ne buxhet behet ne baze te vendimeve gjyqesore te formes se prere kondrejt bashkise. Buxheti I parashikuar eshte ne masen e 25% te buxhetit ten je vit me pare per arsye te uljes se detyrimit edhe per vendime gjyqesore.
- **Shpenzime per Aktivitetet Sportive** eshte parashikuar ne vleren **13,700 mije lek.** Ky fond parashikohet per mbeshtetje financiare te shoqatave te klubit te futbollit te Sarandes, dhe ne kete menyre nxitet zhvillimi I sportit me popullor dhe te kerkuar te komunitetit.
- **Transferta korrente te brendshme** e parashikuan ne shumen **7,000 mije lek** ne buxhet, perfshin;
 - *Financime (parapagime te kthyeshme) per projektet me financim te BE ne shumen 6,000 mije lek.*
 - *Financime te Qarkut ne shumen 1,000 mije leke , ne trajte kuote*
 - *per qarkun Vlore.*
- **Transfertat ne individe dhe familje** jane parashikuar ne shumen **12,654 mije lek** ne rritje me trefishin e buxhetit per vitin 2022. Ne kete shume buxhetohen te gjitha familjet ne nevojte ekonomike te cilat nuk klasifikohen nga buxheti shtetit per perfitim ekonomik, rastet emergjente te identifikuara nga strukturat sociale te Bashkise dhe shumat e arketura nga PAK.
- **Transferta korrente te brendshme** jane parashikuar ne shumen **5,000 mije lek, e perbere prej;**
 - *Fondi Rezerve ne shumen 2,000 mije leke*
 - *Fondi i kontigjences ne shumen 3,000 mije leke*
- **Shpenzime per investime kapitale ne shumen 567,317 mije lek i perbere prej;**
 - *Investime me fondet e veta ne shumen 365,317 mije lek*
 - *Investime me financim te Fzhr ne shumen 202,000 mije lek*

Grafiku 11. Shpenzimet per programin “Menaxhim, Planifikim, Administrim”



2. Programi “Sherbimet publike”

Buxhetimi i programit të shërbimeve publike behet nepermjet, Aparatit të Bashkise, Ndermarrjes së shërbimeve publike për pastrimin, largimit dhe përpunimit të mbetjeve, ndicimin, gjelberimin, dekorimin dhe mirembajtjen e infrastruktures publike me një fond të parashikuar me **203,610 mijë lek** në rritje me rreth 25% krahasimisht me një vit më parë dhe ze 23% të buxhetit nga të ardhurat e veta të Bashkise.

✓ **Ndermarrja e shërbimeve publike.**

Funksioni i Ndermarrjes së shërbimeve publike lidhet ngushtë me funksionet e mirembajtjes së hapësirave publike, rehabilitimin e infrastrukturës, mirembajtjen e ndricimit, gjelberimit, varrezave dhe hapësirave shlodhese, mirembajtjen e plazheve publike dhe sigurinë e jeteve në det. E përbërë prej **119 punonjësish**, Ndermarrja kryen të gjitha funksionet organike që ka në përgjegjësinë e saj. Buxheti i planifikuar për vitin 2023 është 118,250 mijë leke në rritje me rreth 34% të buxhetit aktual. Shuma e parashikuar ze rreth 10% të totalit të buxhetit vjetor. Fondi i pagave është planifikuar në shumën **73,688 mijë lek** në rritje me rreth 14%, të buxhetit vjetor. Rritja e parashikuar ka si qëllim rritjen e fuqisë punëtore të kualifikuar të nevojshme, për të përbushur të gjitha nevojat që ka ndermarrja në funksion të përbushjes së detyrave dhe objektivave të saj.

Mirembajtje në rrjetin elektrik është zeri kryesor në **programin e shërbimeve publike** e administruar nga Ndermarrja e Shërbimeve dhe është parashikuar në shumën 6,300 mijë lek në buxhetin 2023 në rritje me rreth 30% për të përballuar rritjen e cmimeve tashme evidente në treg. Këtu përfshihet mirembajtja e rrjetit elektrik ekzistues, përfshirë amortizimin, zëvendësimi i pjesëve të demtuarsis psh. ndricues dhe zëvendësime kabllit dhe materialeve të tjera në rastet demtimesh të rrjetit elektrik. Për ndricimin publik parashikohet shuma 35,000 mijë lek në buxhetin e Bashkise, për kontratat e furnizimit me energji elektrike.

Mirembajtja e infrastrukturës publike, është një tjetër ze i rëndësishëm në **programin e shërbimeve**, trotuare, kangjella dhe ambiente të përbashkëta publike, e cila konsiston në zëvendësimin dhe riparimin e pjesor në rast demtimesh, janë parashikuar në shumën 3,200 mijë lek në rritje me 7% nga një vit më parë. Investimet në rruget publike e bëjnë me pak të nevojshme nderhyrjen për riparime nga NSH.

Mirembajtje të sipërfaqeve të gjelberuara, është pjesë e buxhetit të Ndermarrjes së Shërbimeve. Shpenzime për gjelberimin është i planifikuar 1,200 mijë lek në buxhet. Në këtë ze shpenzimesh përfshihen mirembajtja rreth 40,000 m² sipër të gjelberuara Sarandë dhe Ksamil (29,500 m²/6500m²). Gjithashtu këtu janë përllogaritur edhe biopreparatet që shërbejnë për eliminimin e semundjeve të pemeve dekorative të qytetit, zëvendësimin e pemeve të demtuara, mirembajtjen e tyre si dhe mbjellja e luleve stinore në lulishtë. Gjithashtu përfshihen edhe shpenzimet materiale dhe të tjera në shërbim të mirembajtjes së varrezave publike të Sarandës dhe Njësise Administrative

Mirembajtje, të dekorit të qytetit, dhe zëvendësim të pjesëve të demtuara, është pjesë e **programit të shërbimeve publike**, në administrim të Ndermarrjes së Shërbimeve. Shpenzime për

dekorin i planifikuar 2,000 mije lek ne buxhetin e vitit 2023. Kjo shume parashikohet per rinovim te dekoreve te amortizuara nga kushtet atmosferike.

- **Vegla pune dhe material te ndryshme** eshte parashikuar ne shumen 1,200 mije lek ne buxhetin e Ndermarjes se Sherbimeve publike.


✓ **Pastrimi dhe largimi i mbetjeve**

Perllogaritja e fondit per pastrimin dhe largimin e mbetjeve, eshte pjese e programit te sherbimeve publike dhe eshte parashikuar ne nje vlere prej **158,226 mije leke** per vitin 2023 ne ritje te konsiderueshme me rreth 73 mil leke. Shtesa vjen ne zbatim te ligjit 10463 date 22.09.2011” Per menaxhimin e Integruar te mbetjeve” dhe VKM nr.319 date, 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve” si edhe dhe me venim te KPP nr,1033 date 21.10.2022 i cili e ben te detyrueshem zbatimin e parashikimit te buxhet te vleres te perllogaritur me keto kosto sherbimi.

Preventivi per llogaritjen e fondit limit, referohet ne kriteret dhe standartet e vendosura nga ligjetdhe udhezimet ne fuqi, bazuar ne analizen e kosos per seicilin nga zerat e sherbimeve, volumin e punes dhe siperfaqen e shtuar te rrugeve te investuar rishtazi. Nisur nga keto referenca dhe qellimi per standartizimin e sherbimit te pastrimit dhe higjenizimit te hapësirave publike te bashkise , nevoja per shtimin e fondeve ne dispozicion eshte e domosdoshme.

- ✓ **Shpenzimet per perpunimin e mbetjeve** ne Landfillin e Bajkaj jane planifikuar **30,000 mije lek** ne te njejtin nivel me nje vit me pare. Perllogaritja e ketij fondi behet ne reference te tonazhit te realizuar faktik dhe cmimit/ njesi pej 22 \$ te negociuar dhe kontraktuar me Bajkaj Land sh.a. Fakti i realizuar per vitin 2022 ne rritje eshte baza e perllogaritjes se fondit buxhetor.

Grafiku 12.Shpenzimet per programin “Sherbime Publike”



3. Programi “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar”

Arsimi ne perberje ka ne perberje 3 programe;

- **Programi 9120 Arsimit parashkollor**, ne te cilin perfshihen perfshihen kopeshtet, cerdhe me personelin mesimor dhe ate mbeshtetes, mirembajtjen e godinave, funksionimin dhe administrimin e tyre. Buxheti financohet nga transferta e pakushtezuar sektoriale ne 55 % dhe 45% me fondet e veta te Bashkise. Fondin per shpenzime operative dhe mirembajtje e financon bashkia me buxhetin nga ate ardhurat e veta. Totali I buxhetit per vitin 2023 i ketij programi eshte parashikuar ne shumen **111,796** mije lek , me 7% rritje ne raport me buxhetin e vitit 2022 , dhe ze rreth 9% te buxhetit te Bashkise.
 - 50,131 mije lek nga buxheti vendor qe perben 45% te buxhetit.
 - 61,638 mije lek nga transfertat qeveritare qe perben 55% te buxhetit.
- ✓ Nga buxheti me te ardhurat vendore financohen 36 punonjes me nje fond page prej **28,039 mije lek** me rritje rreth 30% te fondit te pages dhe fonde per shpenzime operave ne shumen **21,792 mije lek** . Keto fonde sigurojne funksionimin e arsimit parashkollor me mirembajtjen e infrastruktures me ngrohje, ndricim, uje tel internet etj. Per investimet ne institucionet arsimore jane parashikuar 84,419 mije lek qe konsiston ne rehabilitim pjesot te ambienteve mesimdhene. Per vitin 2023 investimi per kete program eshte parashikuar ne vleren 71 mil lekeme financim ne masen 70% nga buxheti I shtetit dhe 30% te ardhurat e bashkise.
- ✓ Nga transferta sektoriale financohen 78 punonjes, edukatore te arsimit parashkollor dhe punonjes mbeshtetes te arsimit parashkollor dhe parauniversitar dhe QKF-ne, me fond pagash dhe sigurime shoqerore ne shumen **61,638 mije lek** ne rritje me rreth 7% nga buxheti aktual. Shpenzimet operative, kancelari, material pastrami, denzifektime, ushqime, mirembajtje, dhe shpenzime te tjera financohen nga buxheti vendor.

Ne administrim te Bashkise Sarande jane 9 kopeshte dhe 2 cerdhe, shpenzimet operative, ne strukture dhe infrastrukturen e mesimdhencies i financon Bashkia. Administrimi i arsimit parashkollor behet nga pushteti vendor si funksion i deleguar, dhe per mirembajtjen e ndertesave ku ushtrojne veprimtarine keto institucione parashikohet fond ne programin e investimeve publike per cdo vit.

- **Programi 9230 Arsimit parauniversitar**

Ne kete program pershihet arsimi i mesem i pergjithshem. Financimi per pagat dhe sigurimet shoqerore per mbeshtetes behet nga transferta e pakushtezuar specifike ne vleren 3,925 mij lek dhe buxheti per shpenzimet operative financohen nga te ardhurat e bashkise.

- **Programi 9240 Arsimi Profesional/ Konvikti.**

Programi financohet nga buxheti I shtetit per pagat dhe sigurimet shoqerore te punonjesve, shpenzimet operative dhe investimet per mirembajtjen e ambienteve te konviktit. Per vitin 2023 buxheti I konviktit per arsimin profesinal eshte parashikuar 19,124 lek.

- **Programi 3280 i “Mbrojtja nga zjarri”,**

Si funksion i deleguar, PMNZSH është një njesi në varesi të pushtetit vendor me një buxhet vjetor prej **19,124 mijë lek**. Ka transferuar të gjitha kompetencat dhe detyrimet në Bashki prej vitit 2015 me një personel prej **17** punonjësish kryen funksionet e shpëtimit nga zjarri dhe operacione të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë e njerzve. Për plotësimin e nevojave shtese për mjete dhe materiale në funksion të operacioneve të shpëtimit, financimi bëhet nga buxheti i bashkisë.

- **Programi 4260 “Administrimi i pyjeve”,**

Është funksion i deleguar në Bashki me kryerjen e reformës territoriale. Fondi për kryerjen e funksionit të këtij programi për vitin 2022 është **2,806 mijë leke** për fond pagash dhe shpenzime operative që kanë të bëjnë me rehabilitim kanalesh ujëtare dhe kulluese në tokat bujqësore dhe të tjera masa që merren për parandalimin e përmytjeve.

4. Programi 8130 “Qendra kulturore dhe shumë sportet”.

Ky program financohet nga buxheti i Bashkisë dhe funksionon si njësi e varesisë me struktura prej 23 punonjësish, specialist të fushës dhe punonjës mbështetës. Institucioni mbështet artin dhe zhvillimin e sporteve në teresi në funksion të jetës kulturore edhe artistike në qytet. Në mbështetje të zhvillimit të qendrës për vitin 2023 parashikimi i buxhetit është në vlerën 17.7% më e lartë në raport me buxhetin aktual në vlerën **29,703 mijë lek**. Nderkohe Qendra Kulturore do të jetë në mbështetje të festimeve dhe eventeve që do të jenë në kalendarin e aktiviteteve të Bashkisë përgjatë vitit 2023.

Bashkia parashikon buxhetim për trajneret e disiplinave sportive në mënyrë që sportet në Sarandë të jenë një opsion për arzetim dhe shfaqje për të gjithë vitin. Prioritet është disiplina e shahut, për të cilin janë financuar vazhdimisht edhe aktivitetet për të rritur dhe femijë.

Fondet e parashikuara për mirëmbajtjen e stadjimit kanë për qëllim ruajtjen e asetit me të rendesishëm që ka Sarandë për Sportin, stadiumin e futbollit që shërben jo vetëm për ndeshjet e Skuadres së Butrintit por edhe për stërvitjen dhe përgatitjen e të rinjve në këto disipline sportive.

Mbështetje do të ketë edhe disiplina e notit, për të cilin janë financuar vazhdimisht edhe aktivitetet komberate.

Për çdo disipline sportive që është pjesë e sporteve që zhvillohen, por edhe të tjera që do të lindin nëpërmjet talenteve të rinj, Bashkia do të jetë mbështetëse për zhvillimin e tyre.

- **Programi 10430**

- **“ Shtëpia e femijes “Vangjel Pulla”.**

Nga të ardhurat e vendore Bashkia mbështet shtëpinë e femijes me një fondë për shpenzimet korrente dhe fondë për investime në funksion të përmirësimit të kushteve dhe ambienteve argetuese për femijet. Për vitin 2023 është parashikuar fond për investime në përmirësimin e kushteve për femijet e qendrës në vlerën **4,000 mijë lek** por edhe fond për shpenzimet e femijeve jorezidente në vlerën **500 mijë lek**.

“Kujdesi social per persona dhe me aftesi te kufizuara “, (Qendra Polivalente).

Ne buxhetin e bashkise parashikohen fonde shtese per te mbeshtetur qendren polivalente qe funksionon me buxhetim nga buxheti I shtetit. Per vitin 2023 fondi I parashikuar do te jete vitin 2,990 mije lek per te financuar personelin shtese me fond pagash , dhe te tjera nevoja qe ka qendra te nevojshme per funksionimin normal . Shpenzime ne buxhetin e investimeve planifikohen edhe per mirembajtjen e godines ne te cilen operon kjo qender.

Qendra multifunksionale per trajtimin e femijeve me aftesi ndryshe.Qendra funksionon si nje institucion qe funksionon si pjese e struktures se administrates se Bashkise ne funksion te mbeshtetjes dhe trajtimit te specializuar te femijeve me aftesi ndryshe. Bashkia financon te plote buxhetin e nevojshem ne mbeshtetje te funksionimin optimal dhe te objektivave qe ka. Funksionimi I saj luan nje rol te rendesishem per integrimin ne shoqeri te femijeve me aftesi ndryshe dhe lehtesimin dhe mbeshtetjen e familjeve te tyre. Kjo qender frekuentohet rregullisht nga 20-30 femije. Struktura per punonjesit eshte planifikuar te jete 10 punonjes kryesisht edukatore dhe punonjes te specializuar per femijet.

Si pjese e kesaj qendre per vitin 2022 eshte hapur edhe nje qender tjeter me fokus femijet nga familje me probleme sociale. Qellimi dhe objektivat e hapjes se qendres eshte te ndihmoje femijet per edukimin e tyre nepermjet leximit, kryerjen e studimit jashte kohes se mesimit, ushqimin e tyre si edhe aktivitete dhe argetime ne kohen e lire. Fondi pagave I llogaritur si pjese e buxhetit te bashkise eshte per buxhetin 2023 eshte parashikuar rreth **6,420 mije lek** . Shpenzimet korrente dhe te tjera shpenzime per investime do te financohen nga Bashkia.

“Kujdesi social per persona te semure dhe me aftesi te kufizuara “


Ne kete program perfshihen te gjitha fondet qe kane te bejne me transfertat ne familjet apo individe per paaftesi dhe trasfertat qe behen nepermjet ndihmes ekonomike per familjet ne nevoje te klasifikuara nga sherbimi social, ne baze te kriterëve qe percaktojne ligjet dhe udhezimet perkatese. Ne buxhetin e vitit 2023 fondi i parashikuar per kete program edhe 226,000 leke. Nga Buxheti i shtetit trajtohen 1,897 persona me aftesi te kufizuara dhe rreth 205familje ne nevoje me ndihme ekonomike. Nga buxheti me fondet e veta jane parashikuar 12,654 mije leke te cilat do te shkojne per shtresat ne nevoje;

Nr	Emertimi	Srukura ne numer	njesia	sasia	Fondi mujor	Fondi vjetor 2022
	Mbeshtetje sociale gjithsej					12,654
1	Popullsia gjithsej	56,124				
2	Familje gjithsej	19,108				4,657
3	Numri I familjeve ne skemen e N.E	30	muaj	12	209	2,507
4	Shperblime per raste te veçanta	10	nr	10	50	500
5	Sherbime emergjente ne familje	8	muaj	12	121	1,450
6	Buxhetim gjinor					200
7	Kthime shumash per PAK te arketuara	1				400
8	Sherbime sociale per familje ne nevoje(Cuka)					2,440
9	Aktivite femije(paketa mjete shkollore,dhurata etj)					500
	TOTALI					12,654

5. Programi 9240 “Konvikti i shkolles se mesme profesionale”

Financohet nepermjet transfertes se pakushtezuar sektoriale me nje fond prej **19,124** mije lek per vitin 2023. Ne administrim te Bashkise konvikti akomodon dhe kujdes nxenesit e shkolles se mesme profesionale “Antonio Athanas”. Fondi eshte i parashikuar per paga dhe sigurime shoqerore per stafin prej 12 punonjes ne 45% te buxhetit , shpenzime operative, 35% dhe investime ne funksion te ketij institucioni ne masen 19%. Prej vitin 2021 nxenesit do te frekuentojne konviktin pa pagese, iniciative kjo e Bashkise dhe Keshillit te Bashkise. Ne zerin “Investime” eshte parashikuar fondi prej **3,775** mije lek per rikonstrukcion te brendshem te konviktit.

Grafiku 13. Struktura buxhetore e Shpenzimeve sipas programeve per vitin 2023



1. Investimet Kapitale.

Investimet Kapitale janë parashikuar ne nivele ambicioze si ato projekte te financuara nga te ardhurat e bashkise ashtu edhe ato te financuara nga buxheti I shtetit. Prioritetet e vendosura ne hartimin e programit te investimeve ka per synim ndikimin e efekteve tek qytetaret.

Investimet ne infrastrukturen rrugore mbetet nje nga prioritetet kryesore ne listes se investimeve publike, e pasuar me projektet ne ujin e pishem dhe rrjetin e brendshem te tij, investimet ne Arsim ne permiresimin e kushteve te mesimdhënies kryesisht ne arsimin 9 vjecar, investime te tjera ne

sherbimet publike te gjitha me akses te drejtperdrejte tek banoret dhe me synim permiresimin e jeteses se perditshme te tyre, ne gjithe territorin e bashkise. Financimi i Investimeve behet e mundur nepermjet dy burimeve;

○ *Investimet me financim nga buxheti i shtetit.*

Per vitin 2023 vlera e parashikuar ne buxhet prej **202,000 mije lek**, ne 76% te vleres perbehet kryesisht nga projekte ne zbatim dhe ne 24% nga projekte ne pritje per financim nga FSHZH.

Me 46% te totalit te investimeve, nepermjet financimit te ketyre projekteve synohet:

- Permiresimin dhe zgjidhjen perfundimtare te furnizimit me uje te zonave periferike te Sarandes, dhe Zones se Njesise administrative Ksamil.
- Permiresimin e kushteve ne shkollat 9 vjecare dhe krijimin e standarteve te mesimdhenies ne nivele bashkohore.
- Rikonstrukcionin e Kinoteatrit te Sarandes, si qendra me e rendesishme e edukimit argetimit dhe kultures, qe do tu sherbeje per te gjitha grupmoshave.

○ *Investimet me Financim te Brendshem.*

Financimi nga te ardhurat e veta te Bashkise eshte burimi kryesor ne programin e investimeve publike me rreth 54% ne vleren 245,285 mije leke dhe ka per objektiv ;

- Permiresimin e infsatruktures rrugore ne te gjithe territorin e Bashkise, duke synuar askesim dhe permiresim te cilesise se jeteses per te banoret ne te gjithe territorin.
- Shtim te rrugeve te reja, kryesisht ne periferite e Sarandes duke i dhene prioritet zhvillimit te gjitha njesive te banimit nepermjet turizmit.
- Nderhyrje ne infrastrukturen publike te fshatrave, Gjashte, Cuke, Shelegar, Metoq, Manastir dhe Berdenesh per te rritur cilesisht jetesen e banoreve me prespektiven zhvillimit e metejshe me turizmit edhe ne fshatra.
- Azhornimin e tokave bujqesore dhe paisjen me certifikata pronesia te bujqeve, per ti hapur rrugen zhvillimit te tokes bujqesore, si nje nga sektoret me efekt kryesor ne ekonomine kombetare.
- Per zhvillimin e metejshe me te zones urbane ne Sarande jane parashikuar Planet e Detajuara Vendore duke i hapur rrugen investimeve nga sipermarrjet private me prioritet ne fushen e turizmit.
- Permiresimin e menaxhimit te integruar te mbetjeve, nepermjet investimit per rinovimin e aseteve si kontejnere mjete teknologjike etj.

- Permiresimin e metejsheem te sinjalistikes horizontale e vertikale, duke lehtesuar ne kete menyre qarkullimin e mjeteve dhe kembesoreve kryesisht ne sezonin turistik.
- Shtimin e sipërfaqeve te gjelberta, ne hapësirat publike dhe ne rruget interurbane.
- Rehabilitimin e ish vendgrumbullimeve te mbetjeve urbane, duke i kthyer ne hapësira estetike te gjelberuara.
- Permiresimin e fasadave te banesave te Sarandes, duke nisur nga lagjet me te aksesueshme nga vizitoret vendas dhe te huaj. Kjo do te jete nje vlere e shtuar per qytetin duke bere edhe korigjimet e mundshme te zbatimit te planit rregullues vendor te devijuar nder vite.
- Permiresimin e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha dhe te zeza, duke investuar ne shtimin e kapacitetit kullues te tubacioneve duke normalizuar funksionimin e tyre.
- Mirembajtjen e institucioneve arsimore parashkollor dhe parauniversitar, me qellim krijimin e kushteve normale ne mjediset e edukimit te brezit te ri.
- Zgjerimin dhe permiresimin e ambienteve sportive neper shkolla dhe ne mjediset te tjera publike, per te beret e mundur aksesimin e tyre nga te gjitha grupmoshat.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë , Parqe Arkeologjike si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në te gjithë bashkine.
- Edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar te qendres kulturore , me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.


○ **Investimet, Te ndara sipas programeve buxhetore;**

- 1- *Investime per administraten* e bashkise dhe Nj.a Ksamil eshte parashikuar ne vleren 5,262 mije leke, qe do te bejne te mundur rinovimin e pjeshem te paisjeve te zyrave.
- 2- *Menaxhim te tokes bujqesore* eshte planifikuar 25,150 mije leke dhe eshte parashikuar azhornim topografik te tokave bujqesore dhe perfundim te kanalit ujites Ksamil.
- 3- *Rruge rrjete dhe transport publik* eshte planifikuar ne vleren 110,192 mije leke . Jane perfshire rruget per rehabilitim ne infrastrukturen e rrugore dhe transportin publik.
- 4- *Investime ne sherbimet publike*, jane planifikuar ne vleren 37,976 mije leke. Eshte mbajtur ne vemendje rehabilitimi i hapësirave publike, sinjalistikat, rinovim kontenjeresh.
- 5- *Investime ne rrjetin ujesjelles kanalizime* eshte planifikuar ne vleren 109,888 mije leke. Ne masen 87% te saj eshte me financim nga buxheti i shtetit, me objekte ne rikonstrukcion dhe te KUZ- eve, ujesjellsave ne lagjet e Sarandes dhe perfundimin e projektit per ujesjellesin e Ksamilit te miratuar per financim nga Buxheti i Shtetit ne buxhetin e 2021. Kerkesat me emergjente kane qene per nderhyrje ne kanalizimet e ujrave te bardha e te

zeza ne territorin e Ksamilit dhe Sarandes, dhe ato do te perballohen me te ardhurat e bashkise.

- 6- *Investime ne arsim* jane planifikuar 134,419 mije leke. Eshte planifikuar rikonstrukcion te shkolles 9 vjecare si investim kapital, dhe mirembajtje te shkollave egzistuese.
- 7- *Investime ne kulture dhe art* jane te planifikuara ne buxhet ne vleren 24,398 mije leke. Jane planifikuar kryesisht rikonstrukcion te mjediseve ne Bashki dhe QKF.

Grafiku 14. *Investimet me financim ng ate Ardhurat Vendore per vitin 2023 sipas programeve ne 000/leke.*



Te ndara sipas ndarjeve territoriale;

- 1- *Saranda* eshte parashikuar vlera 299,787 mije leke.
- 2- *Ksamili* eshte planifikuar ne vleren 119,533 mije leke.
- 3- *Metoqi*, eshte planifikuar ne vleren 8,500 mije leke.
- 4- *Gjashta, Cuka* eshte planifikuar ne vleren 16,430 mije leke.
- 5- *Berdenesh, Manastir* eshte planifikuar ne vleren 3,036 mije leke.

Grafiku 15 *Investimet sipas ndarjeve administrative per vitin 2023. (000/leke)*




Tabela 8. Projektet e Investimeve Kapitalet e parashikuara per vitin 2023.

Nr	Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per vitin 2023			
		Vlera e plete investimit	Burimi i financimit		
			Financim nga Grandi	Financim nga te ardhurat	Financim nga tranf e pakushtezuar
TOTALI		447,286	202,000	116,415	128,871
1	Paisje elektronike dhe paisje funksion te administrates	3,542			3,542
2	Paisje elektronike dhe paisje funksion te administrates	3,542			3,542
3	Azhornime te tokes bujqesore	13,000		13,000	
4	Rehabilitim i kanalit ujites Ksamil , pjesa e pare	12,150		12,150	
5	Rikualifim i rruges "Bilal Golemi "	4,136		4,136	
6	Blerje mjete transporti	5,170		5,170	
7	Shkallare Lidhese nga rruga ``Gjergj Araniti`` tek rruga ``Lefter Talo``	5,060			5,060
8	Rikonstruksion te rrugeve te brendshme ne Lagjen nr 3 dhe Lugu I Dardhes	8,096			8,096
9	Rikonstruksion te rrugevedhe shkallareve ne lagjet e Sarandes	12,144			12,144
10	Riveshje e pjeseve I shtresave asfaltike ne rruget e Sarandes	5,060			5,060
11	Rikualifikim dhe shtrim te rrjetit Rrugor ne Ksamil	19,300		19,300	
12	Nderhyrje ne infrastrukturen e brendshme Ksamil	19,000		19,000	
13	Rikualifikim i rrugeve te brendshme me asfalt ne Gjashte	4,554		4,554	
14	Rikualifikim i rrugeve te brendshme me beton ne Metoq dhe varrezat Shelegar	2,550			2,550
15	Rikonstruksion I varrezave publike Sarande, Gjashte Shelegar,Metoq.	6,050			6,050
16	Rikualifikim i rrugeve te brendshme me beton ne Berdenesh	3,036		3,036	
17	Rikualifikim i rrugeve te brendshme me beton ne Çuke , Manastir	2,530		2,530	
18	Plane te detajuar vendore	5,000		5,000	
19	Mbjellje pemesh ne rruget publike	6,000			6,000
20	Supervizime kolaudime	2,000			2,000
21	Blerje kontenier per pastrimin	5,176			5,176
22	Rikonstruksion I ambjenteve higjenike te qytetit(tualet)	4,306			4,306
23	Lyerje fasadash ne Sarande	10,000			10,000
24	Sinjalistika horizontale, vertikale	9,000			9,000
25	Rehabilitim I ish vendgrumbullimit te mbetjeve,Volloder	7,000			7,000
26	Rikonstruksioni I rruges 47	3,000		3,000	
27	Rikonstruksion I Ujesjellesit Ksamil& Depo+ Rrjeti shperndares Lagj. Nr 3 dhe Nr.4	68,833	68,833		
28	Rehabilitim te kanalizimeve ne rrugen " Vangje Pandi"	15,100		15,100	
29	Furniz.me ujë zona periferike L.Dardhë&B.Rexhepi	25,955	25,955		
30	Investime ne infrastrukturen arsimore ne shkollen 9 vjecare " 9 Tetori"	3,050			3,050

31	Hidroizolim i shkolles se mesme ne Ksamil dhe akomodim te salles se mesuesve	517			517
32	Shkolla 9 vjecare Gjashte/rrethimi i shkolles	702			702
33	Shkolla 9 vjecare Cuke/ sistemim ambientesh higjenike dhe fusha e lojrave	776			776
34	Rikonstruksion banesa sociale ne Cuke	900			900
35	Kopeshti 1/ Rehabilitim shkallesh + mbulim me tende	970			970
36	Kopeshti 2/ Cerdhja Suvatim + lyerje	569			569
37	Kopeshti 3+ cerdhe/ Rikonstruksion tualete kati I dhe ballkoni	620			620
38	Kopeshti Metaq/ Izolim i catise	487			487
39	Shkolla 9 Tetori + Ksamil/dyer te brendshme	569			569
40	Rikonstruksion,shkolla 9-Vjecare "Adem Sheme" Sarande	71,515	57,212		14,303
41	Investime ne ambientet e Konviktit I Shkolles Ekonomike	3,744			3,744
42	Rikonstruksion te salles se mbledhjeve ne Bashki	8,596			8,596
43	Rikonstruksion I Salles se Kinoteatrit	50,000	50,000		
44	Rikonstruksion tek shtepia e femijes ``Vangjel Pulla``	4,719		4,719	
45	Ndertim kendi sportiv	4,048			4,048
46	Rikonstruksion I Muzeumeve	3,036			3,036
47	Rikonstruksion te godines se QKF	3,999		3,999	

